

VENDIM
Nr. 41, datë 21.1.2015

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 378, DATË 12.8.1999, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KALIMIN E SË DREJTËS SË PËRFAQËSUESIT TË
PRONARIT PËR DISA OBJEKTE, PRONË PUBLIKE, ORGANEVE TË QEVERISJES
VENDORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 7926, datë 20.4.1995, “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, të neneve 13, 14 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pasuritë e paluajtshme shtetërore”, të ndryshuar, të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e objekteve, që i bashkëlidhet vendimit nr. 378, datë 12.8.1999, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të hiqet prona me emërtimin “Sheqeri Maliq” sh.a.
 2. Prona “Sheqeri Maliq” sh.a., përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, transferohet në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.
 3. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia Maliq për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama